



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Cooperation Office Kosovo

# (PA)CENUESHMËRIA E SISTEMIT TË PROKURIMIT NË KOSOVË

RAST STUDIMI

NËNTOR 2016

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

## Përmbledhje e të gjeturave:

- Prokurimi Publik mbetet i cënueshëm ndaj korrupsionit
- Zyrtarë të lartë shtetëror përballen me aktakuza për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare
- Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka bërë shkelje ligjore gjatë kohës sa ka refuzuar nënshkrimin e tri kontratave me vlerë prej 12 milion EURO, mbi gjashtë muaj.
- Ministri i Financave, Avdullah Hoti, nuk ka marrë përbazë qëllimshëm opinionin nga KRPP lidhur me interpretimin e ligjit të ri për prokurim publik dhe obligimin për nënshkrim të kontratave me vlerë të mëdha nga ana e Ministrit
- Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka ushtruar ndikim të paligjshëm mbi Drejtorin e AQP-së Mursel Rracaj kur i ka kërkuar procedimin e kontratave me mungesë të nënshkrimit të tij.
- Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka ushtruar presion mbi institucionet e pavarura sikurse OSHP, AQP dhe Auditori i përgjithshëm kur i ka ftuar në takim për të ju treguar si duhet vepruar dhe duke kërkuar këshllim. Ministri ka dëmtuar integritetin e institucioneve të pavarura
- Ministri i Financave, Avdullah Hoti, duke refuzuar nënshkrimin e kontratave me vlerë prej 12 milion EURO ka mundur të i shkaktoj dëm buxhetit të shtetit
- OSHP dhe Auditori i Përgjithshëm kanë vepruar jashtë ligjshëm kur kanë marrë pjesë në një takim të thirrur nga organi qeveritar për të marrë udhëzime se si të veprohet dhe për të këshilluar ministrin për të mos bërë shkelje ligjore.

## PËRMBAJTJA

I.	HYRJE.....	5
II.	METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	6
III.	PROKURIMI PUBLIK NË KOSOVË (I PREKUR NGA KORRUPSIONI).....	7
1.	Rregullimi ligjor dhe ndryshimet e fundit ligjore në prokurimin publik.....	7
2.	Mekanizmat institucional dhe akterët në sektorin e prokurimit publik në Kosovë.....	8
IV.	RASTI “HOTI”.....	9
1.	Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit Publik dhe hyrja në fuqi e ligjit të ri.....	9
2.	Refuzimi i paligjshëm i Ministrit për të nënshkruar kontratat.....	10
3.	Ndikimi i paligjshëm i Ministrit në AQP për të zbatuar kontratat.....	11
4.	Këshillimi i paligjshëm me institucione të pavarura për nënshkrim të kontratave.....	12
5.	Pjesëmarrja e Paligjshme e Autoriteteve të Pavarura.....	14
6.	Ministri Nënshkruan Kontratat pas 6 muaj refuzimi.....	14
V.	PËRFUNDIME.....	16
	ANEKS I.....	18
	KRONOLOGJIA DHE PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E RASTIT.....	18
	Prokurimi me Nr: AQP 15 003 211 me vlerë prej 4.8 milion Euro.....	18
	Prokurimi me Nr: AQP 15 002 111 me vlerë prej 4.5 milion Euro.....	18
	Prokurimi me Nr: AQP 15 004 111 me vlerë prej 2.8 milion Euro.....	19

## I. HYRJE

Prokurimi publik në Kosovë është një prej sektorëve më të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe keqpërdorimit të parasë publike. Kosova - përkundër përpjekjeve në këtë drejtim - ende nuk ka arritur të ndërtojë një sistem të prokurimit efikas dhe i cili garanton paanshmëri, llogaridhënie dhe transparencë për mënyrën se si institucionet publike shpenzojnë paratë e taksapaguesve kosovar. Zyrtarë të prokurimit, zyrtarë të lartë shtetëror dhe ish-udhëheqës të institucioneve mbikëqyrëse të prokurimit përballen me aktakuza për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare.<sup>1</sup>

Komisioni Evropian, përmes raportit të progresit, vazhdimisht ka kritikuar Kosovën për nivelin e lartë të korrupsionit në prokurim publik dhe ka bërë thirrje për monitorim të procesit të tenderimit dhe për llogaridhënie më të madhe.<sup>2 3</sup>

Që nga viti 2008-të, ligjet të cilat rregullojnë sistemin e prokurimit në Kosovë, kanë pësuar vazhdimisht ndryshime. Ligji për prokurimin publik i vitit 2011 krijoi Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) me qëllim të centralizimit të procedurave të prokurimit dhe rritjes së efikasitetit në prokurim.<sup>4</sup> Ligji kërkonte që nënshkrimi i kontratave me vlera të mëdha të bëhej edhe nga ministri i financave.<sup>5</sup> Gjatë vitit 2015-të, AQP-ja inicioi dhe udhëhoqi një numër të procedurave të prokurimit me vlera të mëdha.<sup>6</sup> Ndërkohë në fillim të vitit 2016-të, ligji për prokurimin publik i vitit 2011-të u ndryshua dhe u plotësua me një ligj të ri për prokurimin (05/L-068)<sup>7</sup>. Ligji i ri nuk kërkonte më që kontratat e prokurimit me vlera të mëdha dhe ato të udhëhequra nga AQP-ja, të nënshkruheshin edhe nga ministri i financave.

Për të i'u ikur paqartësive, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në faqen zyrtare të saj, kishte dhënë një këshillë se si duhet të interpretoheshin ndryshimet me ligjin 05/L068, ku qartazi këshillonte që procedurat e filluara me ligjin e vjetër të përfundoheshin me po të njejtin ligj.

Këto këshilla nuk u përfillën nga Ministri i Financave, Abdullah Hoti. Në rastin e prokurimit të tri llojeve të ndryshme të furnizimeve dhe shërbimeve nga AQP-ja për institucionet qendrore, Ministri i Financave, Avdullah Hoti, për muaj të tërë mbajti peng disa procedura të prokurimit. Ministri pretendonte se sipas ligjit të ri, ai nuk detyrohej t'i nënshkruante kontratat me operatorët ekonomik të përzgjedhur nga AQP-ja.

Siç dëshmon ky hulumtim nga Lëvizja FOL, Ministri Hoti, për arsye të panjohura refuzoi të nënshkruaj kontratat me të cilat obligohej me ligj, prolongoj pa arsye procesin, ndërmori një mori veprimesh të kundërligjshme, mes tjerash duke ushtruar presion politik mbi sherbyesit civil dhe duke ndërhyrë në pavarësinë e institucioneve të pavarura sikurse OSHP-ja si dhe rrezikoi t'i shkaktojë dëme të mëdha buxhetit të Kosovës.

<sup>1</sup> Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kundër Fatmir Limaj dhe të tjerët (rasti i njohur si "MTPT"); Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kundër Esat Tahiri dhe të tjerët (rasti i njohur si "KEK" ku gjykohen edhe Kryetari i Skenderajt Sami Lushtaku dhe Ish-kryetari i OSHP-sw Hysni Hoxha).

<sup>2</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovë për vitin 2016, faqe 46.

<sup>3</sup> Komisioni Evropian, 2015, p. 41

<sup>4</sup> Ligji për Prokurimin Publik 2011, neni 95.

<sup>5</sup> *Po aty*, neni 26.

<sup>6</sup> Kontrata me vlerë të madhe janë kontratat mbi 125,000.00 Euro për mallra dhe shërbime ose 500,000.00 Euro për punë.

<sup>7</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11332>

Më këtë, ai dëshmoi se Kosova është ende larg krijimit të një sistemi të prokurimit me integritet, profesional dhe të de-politizuar.

Lëvizja FOL bënë monitorimin e vazhdueshëm të prokurimit publik në Kosovë. Është në mandatin e Lëvizjes FOL, si organizatë që angazhohet për një qeverisje të mirë përmes transparenecës dhe llogaridhënies, që të bëjë analiza dhe hulumtime të tilla të cilat synojnë të përmirësojnë sistemin e prokurimit publik, duke adresuar keqpërdorimin dhe duke kërkuar llogaridhëne.

Lëvizja FOL pas raportimit të rastit në media, ka filluar hulumtimin e saj për tre muaj ku ka analizuar gjithë procesin nëpër të cilin kanë kaluar procedurat për tri lloje të ndryshme të furnizimeve dhe shërbimeve nga AQP-ja për institucionet qendrore. Gjatë kësaj kohe janë analizuar qindra faqe dokumentesh; ligje, rregullore, udhëzime administrative, rekomandime dhe raporte, janë shkëmbyer dhjetëra e-maila me institucionet publike dhe janë konsultuar disa avokatë dhe juristë për të vërtetuar gjetjet.

Gjetjet janë alarmante dhe tregojnë se institucionet e pavarura, janë në presion të vazhdueshëm nga politika.

Lëvizja FOL do të vazhdojë edhe në të ardhmen që të luaj rolin e saj për të kërkuar një qeverisje më të mirë, e cila është transparente dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve. FOL pret që institucionet të bëjnë punën e tyre duke analizuar këto të gjetura dhe duke marrë masat e duhura që do të dërgonin në llogaridhënie, nga personat të cilët kanë shkelur ligjin por edhe duke ndëmarrë masa të cilat do të parandalonin veprime të tilla në të ardhmen.

Ruajtja e pavarësisë së institucioneve të pavarura është jetike për të garantuar një proces transparent dhe meritore në prokurimin publik por edhe për parandaluar veprimet korruptive në këtë sektor.

Çdo presion dhe ndërhyrje politike duhet të dënohet.

## **II. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Ky hulumtim bazohet në dokumente publike të publikuara në faqet zyrtare, në dokumente publike të siguruara përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare, në dokumente publike të siguruara nga hulumtues të pavarur si dhe në dokumente të rrjedhura të cilat janë publikuar në media.<sup>8</sup> Më tutje hulumtimi bazohet në analizën dhe krahasimin e bazës ligjore, që rregullon sistemin e prokurimit në Kosovë dhe aplikimin e kësaj baze ligjore në raport me faktet dhe rrethanat e rastit të hulumtuar. Hulumtimi bazohet në burime primare dhe ato sekondare.

Në burimet primare përfshihen ndër të tjera; ligjet dhe udhëzimet administrative, procedurat e prokurimit të udhëhequra dhe konkluduara nga AQP-ja si dhe kontratat publike kornizë, dokumentet publike të siguruara përmes qasjes në dokumente publike dhe nga hulumtues të pavarur. Në burimet sekondare përfshihen ndër të tjera; raportimet e mediave dhe të organizatave të shoqërisë civile. Gjithsej janë konsultuar dhe analizuar rreth 200 faqe të kornizës ligjore, dokumente, strategji, raportime të mediave dhe dokumente të tjera relevante.

---

<sup>8</sup> “Ministri Hoti bënë presion për tri kontrata 12-milionëshe”, Gazeta Koha Ditore, 20 qershor 2016; “Hoti konfirmon presionin për tre tenderët 12-milionësh”, Gazeta Koha Ditore, 21 qershor 2016; “Ministri Hoti shtyn firmosjen e jashtëligjshme të kontratave 12-milionëshe”, Gazeta Koha Ditore, 23 qershor 2016; “Ministri zmbreset për kontratat 12-milionëshe”, Gazeta Koha Ditore, 05 shtator 2016.

### III. PROKURIMI PUBLIK NË KOSOVË (I PREKUR NGA KORRUPSIONI)

Prokurimi publik konsiderohet se i nënshtrohet korrupsionit.<sup>9</sup> Aktualisht, në gjykatat kosovare janë duke u gjykuar ish-ministra, menaxherë të lartë dhe zyrtarë të prokurimit nga institucionet publike, ish-udhëheqës të institucioneve mbikëqyrëse të prokurimit, kryetarë të komunave, biznesmenë dhe doktorë, për vepra të korrupsionit që kanë të bëjnë ose lidhen me prokurimin në Kosovë.<sup>10</sup>

Sipas një hulumtimi të opinionit publik të ndërmarrë nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), rezulton se qytetarët e Kosovës janë më së shumti të pakënaqur me prokurimin publik dhe rekrutimin në shërbimin civil të Kosovës.<sup>11</sup> Sipas organizatës ndërkombëtare monitoruese të korrupsionit Transparency International, partitë politike, sistemi i drejtësisë, bizneset dhe zyrtarët publik janë disa prej sektorëve më të korruptuara në Kosovë.<sup>12</sup> Këta katër sektorë ndërveprojnë aktivisht në sistemin e prokurimit në Kosovë.

#### 1. Rregullimi ligjor dhe ndryshimet e fundit ligjore në prokurimin publik

Që nga viti 2008, ligjet që rregullojnë sistemin e prokurimit janë ndryshuar pothuajse çdo vit. Aktualisht, në fuqi është Ligji për Prokurimin Publik i vitit 2011, i plotësuar dhe ndryshuar me tri ligje shtesë.<sup>13</sup> Sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian në 2016, korniza ligjore në lidhje me prokurimin publik në Kosovë është përgjithësisht në përputhje me të drejtën evropiane dhe parimet tjera të prokurimit publik.<sup>14</sup>

Një ndër ndryshimet që u bënë në Janar në ligjin për prokurim publik ishte edhe ai që i përket nënshkrimit të kontratave.

Ligji bazë i vitit 2011 për prokurim publik, neni 26 parashihte që kontratat me vlerë të mëdha të nënshkruheshin edhe nga Ministri i Financave, në mënyrë që ato të bëheshin të efektshme.

<sup>9</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Progresit 2016, faqe 47.

<sup>10</sup> “Ngrihet Aktakuzë ndaj Shefit të Tenderëve, Hysni Hoxha”, Kallxo.com, i qasshëm në linkun: <http://kallxo.com/ngrihet-aktakuze-ndaj-shefit-te-tendereve-hysni-hoxha/>; raste të tjera përfshinë aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në rastin e ashtuquajtur “MTPT” ku akuzohet për korrupsion ish-ministri i Transportit dhe Post Telekomunikacionit Fatmir Limaj; aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në rastin e ashtuquajtur “KEK” ku akuzohet për korrupsion Kryetari i Skenderajt Sami Lushtaku dhe ish Kryetari i OSHP-së Hysni Hoxha; rasti i Komunës së Prizrenit ku është duke u gjykuar Kryetari i Komunës Ramadan Muja; aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në rastin e ashtuquajtur “Stenta”, ku është duke u gjykuar ish-ministri i Shëndetësisë Ferid Agani.

<sup>11</sup> Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Raporti i Mosaikut për 2015, faqe 17.

<sup>12</sup> Transparency International, Barometri Global i Korrupsionit, i qasshëm në linkun në vijim: <http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=kosovo> (qasur me datën 01.11.2016).

<sup>13</sup> Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, gazeta zyrtare Nr. 18, 19.09.2011; Ligji Nr. 04/L-237 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, gazeta zyrtare Nr. 25, 17.04.2014; Ligji Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, gazeta zyrtare Nr. 1, 06.01.2016 (në tekstin e mëtejme, “Ligji Nr. 05/L-068”); Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin Nr. 05/L-092, gazeta zyrtare nr. 8, 01.03.2016.

<sup>14</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovë për vitin 2016.

Nënshkrimi i kontratave publike nga ministri është një praktikë e krijuar nga viti 2010-të, me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënies në prokurimin publik.<sup>15</sup> Në Janar të vitit 2016 hynë në fuqi ndryshimet e reja të ligjit për prokurim publik që u bënë me ligjin Nr. 05/L-068 për Ndryshimin e Ligjit të Prokurimit. Ky ligj largoi detyrimin për nënshkrimin e kontratave të udhëhequra nga AQP edhe nga Ministri i Financave. Për më tepër ky ligj mundësoi bazën ligjore për fillimin dhe zbatimin e sistemit të prokurimit elektronik në Kosovë.

## 2. Mekanizmat institucional dhe akterët në sektorin e prokurimit publik në Kosovë

Mekanizmat kryesor institucional në fushën e prokurimit në Kosovë janë [Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik](#) (KRPP), i cili është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë.<sup>16</sup> KRPP-ja, për të përmbushur funksionin e saj, harton dhe publikon ndër të tjera; manuale, udhëzues dhe doracakë. Ajo ofron opinione për autoritetet kontraktuese si dhe drafton forma të kontratave dhe formularë.

Neni 87 i ligjit për prokurim publik (04/L-042), percakton qartë funksionet e KRPP-së, ndër tjera; KRPP-ja është organ kompetent ligjor për të ofruar opinione autoriteteve kontraktuese lidhur me vendimet e tyre.

Mekanizmi më i rëndësishëm institucional në sektorin e prokurimit në Kosovë megjithatë është [Organi Shqyrtues i Prokurimit](#) (OSHP), i cili në opinion dhe media njihet edhe si “gjykata e tenderëve”. OSHP-ja është organ i pavarur administrativ i cili rishikon dhe vendosë në lidhje me ankesat e dorëzuara nga palët e autorizuar pranë OSHP-së, për procedurat e prokurimit të zbatuara nga autoritetet kontraktuese. OSHP-ja merr vendime përfundimtare me të cilat anulon procedura të prokurimit, obligon autoritetet kontraktuese të rivlerësojnë ofertat, autorizon autoritetet kontraktuese të vazhdojnë me procedurat e prokurimit.<sup>17</sup> OSHP-ja përbëhet nga pesë (5) anëtar profesionist dhe me integritet të lartë, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

[Agjencia Qendrore e Prokurimit](#) (AQP), është një agjenci ekzekutive e pavarur dhe organizatë buxhetore që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative. Funksioni kryesor i Agjencisë Qendrore të Prokurimit është zhvillimi i procedurave të centralizuara, qoftë në nivelin qendror (Ministri) apo lokal (komuna).

Akterë të rëndësishëm në lidhje me prokurimin publik në Kosovë, krahas mekanizmave institucional më lartë, janë edhe bizneset ose operatorët ekonomik, autoritetet kontraktuese, auditori i përgjithshëm, ministrat, partitë politike, gjykatat dhe shoqëria civile.

---

<sup>15</sup> Nënshkrimi i kontratave edhe nga Ministri si praktikë ka filluar në vitin 2010 pas pretendimeve dhe akuzave për korrupsion në lidhje Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, të udhëhequr atëherë nga Fatmir Limaj.

<sup>16</sup> Ligji i Prokurimit 2011, neni 87.

<sup>17</sup> Ligji i Prokurimit 2011, neni 105.



## IV. RASTI “HOTI”

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-068 në Janar 2016, Ministri i Financave Avdullah Hoti, kishte një dilemë juridike kur para tij gjendeshin tri kontrata publike për t’u nënshkruar. Procedura e prokurimit ishte inicuar dhe zhvilluar me ligjin e prokurimit të vitit 2011-të, i cili në nenin 26, kërkonte që kontrata e udhëhequr nga AQP-ja të nënshkruhej edhe nga ministri i financave për të qenë efektive.

Ligji i ri kishte ndryshuar këtë dispozitë ligjore duke mos obliguar më ministrin e financave që të nënshkruaj kontratat e udhëhequra nga AQP-ja. Në bazë të dokumenteve të siguruara dhe analizuara nga Lëvizja FOL, Ministri Hoti pretendonte se ligji i ri, nuk e obligonte më ministrin të nënshkruante kontratat dhe se ato i konsideronte efektive vetëm me nënshkrimin e Drejtorit të AQP-së.

Sipas një shkrese zyrtare të protokoluar dhe drejtuar Drejtorit të AQP-së, Mursel Rracaj (të cilën e posedon Lëvizja FOL), Ministri Hoti e bazonte argumentin e tij në bazë të një njoftimi me shkrim nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave që mbanë datën 22 Janar 2016, Ministri i kujton Drejtorit të AQP-së se

*“në ndryshimin e fundit të nenit 26 të ligjit për Prokurimin Publik, nuk parashihet që ministri të nënshkruaj këto kontrata”.*

Ky argument ishte rrëzuar dhe binte ndesh me interpretimin që një autoritet ligjor dhe me kompetencë i kishte bërë ndryshimeve të ligjit të prokurimit - KRPP.

KRPP-ja në faqen e saj zyrtare, kishte dhënë opinion ligjor autoriteteve kontraktuese se si duhej qasur ligjit të ri për prokurimin publik.<sup>18</sup>

Duke neglizhuar opinionin nga KRPP-ja, duke refuzuar nënshkrimin pa ndonje argument të qëndrueshëm dhe arsye të ditur, ministri Hoti do të mbajë pezull kontratat për më shumë se gjashtë (6) muaj pa i nënshkruar e në ndërkohë do të involvoj në këtë proces jo ligjor edhe mekanizmat e pavaruar sikurse AQP-ja, OSHP-ja dhe KRPP-ja e madje edhe Auditorin e Përgjithshëm duke dëmtuar rëndë pavarësinë dhe integritetin e tyre.

### 1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit Publik dhe hyrja në fuqi e ligjit të ri

Gjatë vitit 2015 dhe 2016, AQP-ja kishte inicuar dhe zhvilluar tri procese tenderuese të centralizuara<sup>19</sup>. Një proces tenderues është zhvilluar për furnizim të institucioneve publike me material zyrtar, një tjetër për shërbime të transportit ajror dhe procesi i tretë për furnizim me goma për veturat zyrtare. Në përputhje me Ligjin e Prokurimit dhe procesin e prokurimit të zhvilluar, ishin përzgjedhur tre operatorë ekonomik për të kryer furnizimet dhe ofruar shërbimet e kërkuara.

Pas përzgjedhjes së operatorëve ekonomik, kontratat ishin bërë gati për nënshkrim nga AQP-ja si autoritet kontraktues nga operatori ekonomik i përzgjedhur si dhe nga Ministri i Financave, në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 26 të Ligjit të Prokurimit të vitit 2011.

<sup>18</sup> Komunikimet elektronike ndërmjet KRPP-së, OSHP-së dhe AQP-së.

<sup>19</sup> Shiko Aneksin 1 ne fund te raportit.

Kontrata për Shërbime me titull të kontratës “Shërbime të Transportit Ajror” dhe me numër të prokurimit AQP 15 003 211 është protokolluar në AQP me datën 19.10.2015 dhe është nënshkruar nga AQP-ja me datën 04.11.2015, përkatësisht në kohën sa Ligji Nr. 05/L-068 ende nuk kishte hyrë në fuqi, ***rrjedhimisht Ministri i Financave nuk mund të pretendonte se nuk ishte i detyruar të nënshkruaj kontratën në fjalë.***

Një kontratë tjetër për furnizim me titull të kontratës “Kontratë Publike Kornizë për Furnizim me Material Zyrtar Lot II” dhe me numër të prokurimit AQP 15 002 111, është nënshkruar nga personat përgjegjës nga AQP-ja me datën 08.12.2015 respektivisht 10.12.2015 si dhe protokolluar në AQP me datën 11.12.2015. Ngjashëm sikurse kontrata e mëparshme edhe kjo kontratë i ishte dërguar Ministrisë të Financave për nënshkrim në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Prokurimin të vitit 2011-të.

Ligji Nr. 05/L-068 edhe në lidhje me këtë rast nuk kishte hyrë në fuqi ende, ***për çka Ministri i Financave nuk kishte të drejtë të pretendonte se nuk është i detyruar të nënshkruajë këtë kontratë.***

Kontrata e tretë, për furnizim me goma, ishte finalizuar dhe bërë gati për nënshkrim pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-068. Sipas opinionit të KRPP-së, procedurat e inicuar me ligjin e vjetër të prokurimit, duhej të përfundonin me ligjin e vjetër, ***rrjedhimisht edhe në lidhje me këtë, Ministri i Financave nuk kishte të drejtë në argumentin e tij se nuk duhet të nënshkruaj kontratën.***

Ligji Nr. 05/L-068 i cili kishte amandamentuar nenin 26 të Ligjit të Prokurimit të vitit 2011 i cili i mundësonte Ministrinë të Financave të mos nënshkruaj kontratat e ndërmarra nga AQP-ja, kishte hyrë në fuqi me datën 21.01.2016.

Siç dëshmohet nga datat e mësipërme, të gjitha procedurat e prokurimit kishin filluar me ligjin e vjetër. Ministri gabimisht është këshilluar nga zyra ligjore e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me efektin e ligjit të ri dhe ka vepruar në kundërshtim me praktikën dhe me ligjin kur ka synuar të përfundojë me ligj të ri një procedurë të prokurimit e cila ka filluar me ligjin e vjetër.

Për këtë rast, ministri kishte një opinion të qartë nga KRPP-ja të cilin nuk është dashur të injoronte.

## **2. Refuzimi i paligjshëm i Ministrisë për të nënshkruar kontratat**

Ministri i Financave, Abdullah Hoti, ka refuzuar në mënyrë të paligjshme që të nënshkruaj kontratat të cilat ka qenë i obliguar t'i nënshkruaj. Neni 26 i Ligjit të Prokurimit të vitit 2011-të, obligonte Ministrinë e Financave, që të nënshkruaj kontratat e udhëhequra nga AQP-ja. Ky ligj ishte në fuqi deri me datën 21.01.2016.

Së paku dy kontrata, ajo për furnizim me material zyrtar si dhe kontrata për shërbime të transportit ajror, ishin të gatshme për nënshkrim në Tetor respektivisht Dhjetor të vitit 2015.

Pritja dhe mos nënshkrimi i kontratave derisa Ligji Nr. 05/L-068, ka hyrë në fuqi në njërën anë dhe më vonë mos nënshkrimi i kontratave me pretendimin që Ministri i Financave nuk obligohej të nënshkruante kontratat e tilla ishte një mos-veprim i paligjshëm i Ministrisë të Financave, për çka i njëjti ka rrezikuar t'i shkaktojë dëme të mëdha buxhetit të Kosovës.

Në rast të anulimit të proceseve tenderuese sipas të cilave ata ishin shpallur fitues, operatorët

ekonomik do të mund të iniconin padi për kompensim të dëmeve dhe të fitimeve të humbura.<sup>20</sup>

Neni 26 i Ligjit të Prokurimit Publik i vitit 2011-të, në lidhje me efektin juridik të kontratave të panëshkruara thekson se nënshkrimet e zyrtarëve përgjegjës të autoritetit kontraktues dhe Ministrit “...konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe vërtetojnë se kontrata është në pajtim të plotë me këtë ligj. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme.”

Rrjedhimisht, mos nënshkrimi i kontratave nga ana e Ministrit të Financave, ka rrezikuar t'i shndërron kontratat në kontrata të pazbatueshme pra të pavlefshme. Për këtë arsye, operatorët ekonomik do të kishin të drejtë të iniconin padi në gjykatë për kompensimin e dëmeve dhe kompensimin e fitimit të humbur sepse operatorët tashmë kishin një njoftim që i shpallte ata fitues dhe kishin pritje të arsyeshme, që do të realizonin kontratën në njërin anë ndërsa Ministri i Financave, nuk po nënshkruante kontratat në mënyrë të paligjshme.<sup>21</sup>

Siç dëshmohet nga një letër zyrtare e brendshme që mbanë datën 14.06.2015, e dërguar nga Ministri i Financave, Avdullah Hoti për Drejtorin e AQP-së Mursel Rracaj me lëndë “Nënshkrimi i Kontratave”, interpretimi juridik dhe njëherit pozicioni juridik i Ministrit të Financave, Avdullah Hoti, ishte se ai nuk ka nevojë të nënshkruajë kontratat si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-068.

Ministri i Financave krijon këtë pozicion juridik bazuar në një opinion nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave të datës 22.01.2016. Me këtë rast Ministri i Financave, Avdullah Hoti, injoron një opinion kredibil përkatësisht këshillën Nr. 35 të KRPP-së që thekson;

*“të gjitha aktivitetet e iniciuara para datës 21.01.2016 do të implementohen sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik ndërsa të gjitha aktivitetet e prokurimit të cilat janë iniciuar dhe/ose do të iniciohen pas kësaj date, do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237.”*

Sipas këtij interpretimi, Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka qenë i detyruar të nënshkruajë kontratat të cilat ishin iniciuar dhe përfunduar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-068 më 21.01.2016. Një interpretim i tillë madje është në përputhje me parimin e ligjshmërisë sipas të cilit një procedurë e filluar në bazë të një ligji të caktuar, duhet të mbarojë sipas atij ligji dhe jo një ligji të nxjerrë më vonë.

Mbeten të paqarta arsyet pse ministri nuk ka marrë në konsideratë opinionin kredibil të KRPP-së, i cili është autoritet më kompetent për të interpretuar dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me prokurimin sesa Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave.

### **3. Ndikimi i paligjshëm i Ministrit në AQP për të zbatuar kontratat**

Përpos refuzimit të kundërligjshëm për të nënshkruar tri kontratat që gjendeshin para tij, Ministri i Financave, tentoi të ushtroj ndikim të paligjshëm mbi menaxhmentin e AQP-së për të zbatuar kontratat e panëshkruara prej tij rrjedhimisht për të zbatuar kontratat e pazbatueshme. Në letrën e datës 14.06.2016 drejtuar Drejtorit të AQP-së, Mursel Rracaj, Ministri i Financave, Avdullah Hoti, thekson;

<sup>20</sup> Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 173.

<sup>21</sup> Po aty.

*“kërkoj nga ju që pa shtyrje të afateve, në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë Qëndrore të Prokurimit, si person i autorizuar për përbylljen e procesit të prokurimit, të bëni nënshkrimin e kontratave të cekura në pikën 1 të kësaj shkrese, në të kundërtën do të mbani përgjegjësinë për moszbatim të dispozitave të cekura ligjore.”*

Sipas nenit 96 të Ligjit të Prokurimit Publik të vitit 2011-të, Drejtori i AQP-së është zyrtar me pozitë të lartë drejtuese në shërbimin civil të Kosovës. Neni 96, paragrafi 3 thekson se, “Drejtori do të ketë pozicion të barasvlefshëm me Sekretarët e Përgjithshëm dhe do t’i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që kanë të bëjnë me nëpunësit civil në pozita të larta drejtuese”.<sup>22</sup>

Më tutje, përkundër që AQP, në bazë të nenit 94 të Ligjit të Prokurimit Publik të vitit 2011, është institucion në kuadër të Ministrisë së Financave, i njëjti obligohet të veprojë në përputhje me ligjin e prokurimit në cilësi të autoritetit kontraktues dhe jo në bazë të urdhërave ose kërkesave të Ministrisë së Financave.<sup>23</sup>

Insistimi i Ministrit të Financave, Avdullah Hoti, që AQP-ja të vazhdojë me procedurat e prokurimit përkundër mos-nënshkrimit të kontratave nga ana e tij, mund të përbëjë shkelje të ligjit apo edhe vepër penale, për çka organet kompetente duhet të hetojnë dhe të parandalojnë përsëritjen e veprimeve të tilla të cilat çënojnë pavarësinë e institucioneve të pavarura dhe çënojnë integritetin e sistemit të prokurimit në Kosovë.

#### **4. Këshillimi i paligjshëm me institucione të pavarura për nënshkrim të kontratave**

Me datën 22.07.2016 Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ftoi në një takim udhëheqësit e institucioneve të pavarura për konsultim.<sup>24</sup>

Në takimin e datës 22.07.2016 i cili u mbajt në sallën e takimeve të Ministrisë së Financave, morën pjesë: 1) Avdullah Hoti, Ministër i Financave, 2) Blerim Dina, Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, 3) Safet Hoxha, Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, 4) Sami Uka, Anëtar i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, 5) Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, 6) Artan Venhari, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm, 7) Mursel Rraci, Drejtor i Agjencisë Qëndrore të Prokurimit, 8) Enis Spahiu, Drejtor i Departamentit Ligjor pranë Ministrisë së Financave. Së paku dy institucione, sikurse janë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, kanë konflikt interesi dhe s’do të duhej të merrnin pjesë fare në takimin e thirrur nga Ministri i Financave, Avdullah Hoti.

Kjo për arsye se këto dy institucione nuk janë të autorizuara të marrin pjesë në takim të tilla konsultative në njërën anë dhe më me rëndësi, ato janë të mandatuara të shqyrtojnë ankesat që mund të paraqiten në lidhje me ligjshmërinë e nënshkrimit të kontratave ose të auditojnë përkatësisht mbikëqyrin implementimin e tyre dhe ligjshmërinë e shpenzimit të parave publike përmes këtyre kontratave.

Poashtu pjesëmarrja e autoriteteve të pavarura sikurse KRPP-ja dhe AQP-ja, është e

<sup>22</sup> Në bazë të nenit 5 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shërbyesit civil detyrohen të respektojnë parimin e ligjshmërisë në ushtrimin e detyrave të tyre, që nënkupton se të njëjtit nuk mund të ushtrojnë detyrat e tyre në kundërshtim me ligjin.

<sup>23</sup> Ligji i Prokurimit 2011, nenet 94 - 97.

<sup>24</sup> Procesverbali i takimit të datës 22 korrik 2016.

kundërligjshme edhe për faktin se të njëjtat tashmë kishin një qëndrim juridik, i cili ishte i bazuar në Ligjin për Prokurim të vitit 2011.

Më tutje pjesëmarrja e mekanizmave ligjor të sistemit të prokurimit dhe të mbikëqyrjes së shpenzimit të parasë publike në një takim me Ministrin e Financave, ku do të diskutohej për kontrata konkrete të prokurimit publik, është një ndërhyrje e rëndë në pavarësinë dhe integritetin e sistemit të prokurimit në Kosovë dhe një precedent i rrezikshëm për ndërhyrje edhe më të thella në të ardhmen.

Ministri i Financave nuk ka pasur të drejtë të ftoj institucionet e pavarura për t'i konsultuar për zgjidhjet rreth kontratave specifike. Çfarëdo dileme juridike që ai ka mundur të ketë është dashur të konsultohet vertikalisht përkatësisht me zyrën ligjore të Kryeministrit dhe kurrësi me institucione të pavarura dhe në konflikt interesi për rastin konkret.

Më me rëndësi, institucionet e pavarura nuk kanë pasur autorizim dhe kompetencë për të marrë pjesë në një takim të tillë, ***për çka të gjithë mund të konsiderohet se kanë tejkaluar kompetencat e tyre ligjore.***

Pas takimit të datës 22 Korrik 2016, Behxhet Rrukiqi, Shef i Divizionit për Prokurime të Centralizuara në AQP, i dërgon një e-mail autoriteteve kontraktuese përmes të cilit njofton se pas takimit të mbajtur me datën 22 korrik 2016 si dhe pas përgjigjes të OSHP-së të datës 01 Gusht 2016 dhe përgjigjes së KRPP-së të datës 04 Gusht 2016, kontratat janë nënshkruar nga Ministri i Financave.<sup>25</sup>

Çfarëdo përgjigje që OSHP mund t'ju ketë dërguar AQP-së dhe ose Ministrisë së Financave është dhënë në kundërshtim me nenin 105 të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit OSHP-ja nuk është kompetente të ofrojë këshilla për autoritete kontraktuese dhe as të përgjigjet në kërkesa të ndryshme të cilat mund t'i kenë ato. Ky veprim i OSHP-së duket të jetë veprim i koordinuar pas takimit të datës 22 Korrik 2016, ku Kryetari i OSHP-së ishte pajtuar me kërkesën e Ministrit të Financave, Avdullah Hoti, që sa më shpejtë të mbledhë bordin për ta shqyrtuar këtë çështje.<sup>26</sup>

Këshillimi jo-ligjor megjithatë bindi Ministrin e Financave, Avdullah Hoti, që të tërhiqet nga interpretimi i tij dhe i Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, se ai nuk detyrohej të nënshkruaj kontratat e udhëhequra nga AQP-ja dhe të kthehet në pikën fillestare tek interpretimi i AQP-së dhe KRPP-së se procedurat e prokurimit të filluara me ligjin e vjetër të prokurimit, duhej të mbaroheshin me të, rrjedhimisht që Ministri i Financave duhej të nënshkruaj të njëjtat.

Të gjitha këto shkelje të supozuara duhet të hetohen nga organet kompetente. Është e papranueshme që institucionet të cilat duhet të sanksionojnë veprat e kundërligjshme, të angazhohen në këshillimin dhe orientimin e shkelësve. Këto autoritete kanë tejkaluar autorizimet ligjore dhe i janë nënshtruar presionit politik të ministrit duke dëmtuar rëndë integritetin e institucioneve të pavarura.

---

<sup>25</sup> E-maili nga Behxhet Rrukiqi për autoritetet kontraktuese, i datës 5 gusht 2016.

<sup>26</sup> Procesverbali i takimit të datës 22 Korrik 2016, faqe 3.

## 5. Pjesëmarrja e Paligjshme e Autoriteteve të Pavarura

Institucionet e pavarura janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje të veçanta si institucione të pavarura, të cilat nuk i nënshtrohen asnjë autoriteti tjetër publik përpos Kuvendit të Republikës së Kosovës. Institucioni i Auditorit të Përgjithshëm, përcaktohet me nenin 136 të Kushtetutës së Kosovës, si institucion i pavarur që ka për kompetencë të kontrollojë veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike si dhe të kontrollojë përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga institucionet publike.<sup>27</sup>

Kushtetuta e Kosovës, më tutje, në nenin 142 përcakton se *“agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës, janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.”*<sup>28</sup>

OSHP-ja, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, KRPP-ja dhe AQP-ja, janë të përcaktuara si institucione dhe agjenci të pavarura, të cilat nuk i nënshtrohen asnjë autoriteti tjetër publik dhe fushëveprimtaria e të cilave është e rregulluar me ligj.

Pjesëmarrja e tyre në takimin e datës 22 Korrik 2016 të thirrur nga Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka qenë tejkalim i kompetencave dhe autoritetit të tyre dhe për më shumë nënshtrim ndaj një institucioni qeveritar sikurse është Ministria e Financave.

Ligjet dhe rregulloret të cilat rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të pavarura dhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative<sup>29</sup>, përcaktojnë palët e autorizuar, mënyrën e paraqitjes së kërkesave nga palët e autorizuar dhe mënyrën e trajtimit dhe vendosjes në lidhje me ato kërkesa nga institucionet e pavarura. Mirëpo të njëjtat në asnjë rast nuk lejojnë që institucionet e pavarura dhe udhëheqësit e tyre, të marrin pjesë në një proces konsultimi për kontrata konkrete dhe raste konkrete, që janë në fushëveprim të autoriteteve publike, për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me to në mënyrë të paligjshme.

Pjesëmarrja e institucioneve të pavarura në takime të thirrura nga qeveria për arsye të udhëzimit për mos shkelje të ligjit, është shkelje e rëndë e parimit të ndadrjes së pushteteve dhe sundimit të ligjit. Këto shqetësime janë ngritur edhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2016.<sup>30</sup>

## 6. Ministri Nënshkruan Kontratat pas 6 muaj refuzimi

Me datën 04 Gusht 2015, Ministri i Financave, Avdullah Hoti, nënshkroi kontratat në lidhje me të cilat për nëntë (9) muaj kishte insistuar se nuk është i detyruar t'i nënshkruajë. Mekanizmat institucional të prokurimit publik sikurse OSHP, KRPP, AQP dhe ZAP ndihmuan Ministrin Avdullah Hoti, që të ndryshojë mendim pas takimit të thirrur nga ai dhe në të cilën morën pjesë ato.

Takimi i datës 22 Korrik 2016, ishte pasuar me dy përgjigjet nga OSHP-ja dhe KRPP-ja, të cilat

<sup>27</sup> Kushtetuta e Kosovës, neni 136.

<sup>28</sup> Po aty, neni 142.

<sup>29</sup> Ligji Nr. 02L-28 dhe Nr. 05/L-031 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

<sup>30</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2016, faqe 48.

kishin bindur Ministrin e Financave, që të nënshkruaj kontratat në përputhje me detyrimin nga neni 26 i Ligjit të Prokurimit të Vitit 2011. OSHP-ja nuk ka qenë e autorizuar të kthejë çfarëdo përgjigje në kërkesat e paligjshme dhe të dërguara në rrugë jo-formale sikurse ato nga takimi i paligjshëm i datës 22 Korrik 2016. **Çfarëdo përgjigje e kthyer nga OSHP-ja mund të përbëjë vepër penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.**

Lëvizja FOL ka pyetur zyrën e Auditorit të Përgjithshëm dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit për arsyetimin e prezencës së tyre në takimin e datës 22 Korrik 2016. Zyra e auditorit nuk ka arritur të kthej një arsyetim bindës dhe me bazë ligjore për pjesëmarrjen e Auditorit të Përgjithshëm z. Besnik Osmani.

Përgjigja nga Auditori i Përgjithshëm:

*“...në mënyrë specifike, prezenca e bartësve të funksioneve politike në takime ku fizikisht mund të gjendet edhe Auditori i Përgjithshëm, nuk paraqet pengesë ligjore dhe profesionale për të siguruar pavarësinë funksionale, administrative e operacionale të Zyrës sonë”*

Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, nuk është takuar rastësisht me ministrin Hoti pra nuk ishte rastësisht prezent në takimin me Ministrin e Financave, përkundrazi, z. Osmani i ishte përgjigjur thirrje së Ministrisë të Financave për takim, ku qëllimi i tij ishte të konsultohet lidhur me një veprim të cilin ai do të ndërmerre e për të cilin kishte qëndrim juridik për më shumë se gjashtë muaj.

OSHP-ja nuk ka kthyer përgjigje në pyetjen e njëjtë që i është dërguar në adresën zyrtare.



## V. PËRFUNDIME

Sistemi i Prokurimit në Kosovë vazhdon të jetë i ndjeshëm ndaj ndikimit politik dhe i cënueshëm nga korrupsioni, ky konstatim mbështetet edhe nga raporti i progresit për vitin 2016 i Komisionit Evropian. Rasti i ndërhyrjes së Ministrit të Financave, Avdullah Hoti, në sistemin e prokurimit siç është analizuar në këtë dokument është dëshmi e brishtësisë së sistemit të prokurimit, dëshmi e ndërhyrjes dhe tendencës për ndërhyje në institucione të pavarura.

Ky studim nxjerrë në pah gjithashtu edhe integritetin dhe profesionizmin e institucioneve të pavarura sikurse ajo e sistemit të prokurimit. Një humtim nga Lëvizja FOL i publikur në Qershor 2016, lidhur me [integritetin e institucioneve të Kosovës](#), nxjerrë në pah pikërisht mungesën e integritetit të zyrtarëve publik në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Studimi dëshmon gjithashtu se sistemi i prokurimit në Kosovë, është i cënueshëm dhe shton nevojën për një rregullim më të mirë ligjor, i cili do të zvogëlonte dhe pamundësonte ndikimin në institucione të pavarura.

Krijimi i një institucioni qendror sikurse është AQP-ja për udhëheqjen e procedurave të prokurimit përmes një procedure të centralizuar, është bërë për t'i ikur ndikimit nga politika.

Rasti me Ministrin e Financave, Avdullah Hoti, tregon se AQP-ja është subjekt i ndikimit dhe i cënueshëm nga organet qeveritare. AQP-ja dhe institucione tjera të pavarura ju nënshtruan ndikimit kur morën pjesë në takimin e thirrur nga Ministri i Financave, Avdullah Hoti, për të diskutuar për një çështje për të cilën AQP-ja dhe institucione tjera tashmë kishin një pozicion juridik.

Kjo analizë poashtu nxori në pah edhe cënueshmërinë e institucioneve të pavarura dhe të cilat kanë përgjegjësi ligjore për mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit dhe kontrollimin e mënyrës së shpenzimit të parave publike. OSHP-ja e cila referohet si “*gjykata e tenderëve*” për arsye se vendos për ankesa të operatorëve ekonomik dhe palëve të interesuara në procedura konkrete tenderimi dhe vendimet e së cilës janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese, ishte pjesë e këtij takimi “këshillues”.

OSHP-ja e ka të përcaktuar me Ligjin për Prokurimin Publik procedurën për paraqitjen e ankesave ose kërkesave në OSHP si dhe mënyrën dhe procedurën e vendosjes për këto kërkesa.

OSHP-ja nuk mund të vihet në lëvizje në mënyrë tjetër mirëpo vetëm përmes një procesi formal.

Përkundër kësaj, Kryetari i OSHP-së, i'u nënshtrua Ministrit të Financave, Avdullah Hoti, kur pranoi të merr pjesë në takimin e datës 22 Korrik 2016, të thirrur nga Ministri Hoti.

Përveç pjesëmarrjes, Kryetari i OSHP-së ofroi edhe propozime si të dilet nga situata, duke shkelur çdo parim të pavarësisë, profesionizmit dhe të sundimit të ligjit në lidhje me institucionin që ai përfaqëson. Siç është dëshmuar në procesverbal nga takimi i datës 22 Korrik 2016, OSHP zotohet se do të thërras takim të bordit me kërkesë të ministrit Hoti.

Ngjashëm veproi edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, kur dërgoi dy përfaqësuesit më të lartë të institucionit, i cili ka për obligim ligjor të kontrolloj dhe mbikëqyrë mënyrën e shpenzimit të parasë publike.

Kjo analizë dëshmoi se Ministri i Financave, Avdullah Hoti, nuk veproi në bazë të parimeve të sundimit të ligjit dhe të pavarësisë të institucioneve të pavarura kur për më shumë se gjashtë



(6) muaj mbajti peng tri kontrata publike me vlerë 12 milion euro duke refuzuar t'i nënshkruaj.

Ministri Hoti veproi paligjshëm kur i bëri presion AQP-së, që të zbatojë kontratat jo-efektive dhe sidomos kur ftoi në takim institucione të pavarura për t'i konsultuar se si të veprojë.

Çfarëdo dileme juridike që Ministri Hoti mund të ketë pasur, ka pasur mundësi të konsultohet vertikalisht tek Departamenti Ligjor në Kryeministri dhe kurrsezi të konsultohet horizontalisht tek institucione të pavarura.

Prokurimi publik është ndër sektorët më me peshë i cili ndikon direkt edhe në punësimin dhe mirëqenien e qytetarëve. Sipas Komisionit Evropian për vitin 2015-të, janë nënshkruar 10 985 kontrata me vlerë totale rreth 401 milion euro ose 7% të GDP-së.

Është në interes të gjithë qytetarëve që të jenë të siguruar se taksat e tyre menaxhohen me përgjegjësi dhe se institucionet e pavarura sikurse AQP, KRPP, OSHP dhe Auditori i Përgjithshëm, bëjnë punën e tyre profesionale dhe me integritet duke respektuar ligjin dhe duke mos ju nënshtruar presionit dhe ndikimit nga qeveria dhe politika.

Hulumtimi i Lëvizjes FOL, duhet të kuptohet si thirrje për mbrojtje të institucioneve të pavarura, thirrje për profesionalizëm dhe integritet të personave që menaxhojnë me institucionet e pavarura, thirrje për të hequr dorë nga ndikimi në institucione të pavarura dhe thirrje për një shtet ligjor.

Lëvizja FOL pret që organet kompetente të analizojnë të gjeturat nga ky raport dhe të kryejnë punën e tyre për të garantuar një shtet të së drejtës.

## **ANEKS I**

### **KRONOLOGJIA DHE PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E RASTIT**

#### **Prokurimi me Nr: AQP 15 003 211 me vlerë prej 4.8 milion Euro.**

##### **Prill, 2015**

AQP-ja si autoritet qendror i prokurimit me datën 23 Prill 2015 inicioi procedurën e prokurimit me Nr. AQP 15 003 211, për prokurimin e shërbimeve të transportit ajror për institucionet publike. Me këtë datë AQP-ja publikoi Njoftimin për Kontratë, me të cilin ftoi operatorët ekonomik që të paraqesin ofertat e tyre.<sup>31</sup>

##### **Qershor, 2015**

Me datën 23 Qershor 2015, AQP-ja publikoi njoftimin për dhënie të kontratës me të cilin kishte përzgjedhur operatorin ekonomik për ofrimin e shërbimeve të transportit ajror.<sup>32</sup>

##### **Gusht, 2015**

Me datën 04 Gusht 2015, OSHP-ja kishte pranuar si të bazuara ankesat e disa operatorëve ekonomik dhe i kishte kërkuar AQP-së të rivlerësonte ofertat e operatorëve ekonomik.<sup>33</sup> Pas procesit të ri-vlerësimit, me datën 14 Gusht 2015, AQP-ja kishte publikuar njoftimin për dhënie të kontratës, me të cilën kishte përzgjedhur një operator tjetër ekonomik nga njoftimi i parë.<sup>34</sup>

##### **Nëntor, 2015**

Me datën 04 Nëntor 2015, Kontrata për Shërbime ishte nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës të AQP-së.<sup>35</sup>

##### **Qershor, 2016**

Operatori ekonomik ka nënshkruar kontratën me datën 28 Qershor 2016.<sup>36</sup>

##### **Gusht, 2016**

Kjo kontratë është nënshkruar nga Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe bërë efektive përfundimisht me datën 04 Gusht 2016.<sup>37</sup>

#### **Prokurimi me Nr: AQP 15 002 111 me vlerë prej 4.5 milion Euro.**

##### **Maj, 2015**

AQP-ja, me datën 13 Maj 2015 inicioi procedurën e prokurimit me Nr. AQP 15 002 111, për furnizim me material zyrtar të institucioneve publike duke publikuar njoftimin për kontratë.<sup>38</sup>

##### **Korrik, 2015**

<sup>31</sup> Njoftimi për Kontratë, AQP 15 003 211, 23 Prill 2015.

<sup>32</sup> Njoftimi për Dhënie të Kontratës, AQP 15 003 211, 23 Qershor 2015.

<sup>33</sup> Vendimi i OSHP-së PSH Nr. 230/15; 231/15 dhe 235/15, i datës 29 Korrik 2015, publikuar me datën 04 gusht 2015.

<sup>34</sup> Njoftimi për Dhënie të Kontratës, AQP 15 003 211, 14 Gusht 2016.

<sup>35</sup> Kontrata për Shërbime të Transportit Ajror, AQP 15 003 211.

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> Njoftimi për Kontratë, AQP 15 002 111, 13 Maj 2015.

Me datën 23 Korrik 2015, AQP anuloi këtë procedurë të prokurimit për shkak se nuk ishin paraqitur tri apo më shumë oferta të përgjegjshme.<sup>39</sup>

#### **Gusht, 2015**

Me datën 28 Gusht 2015, AQP-ja ritenderoj procedurën e prokurimit Nr. AQP 15 002 111.<sup>40</sup>

#### **Shtator, 2015**

Me datën 22 Shtator 2015, AQP-ja vazhdoi afatin për paraqitjen e ofertave në lidhje me procesin e prokurimit Nr. AQP 15 002 111, për furnizim me material zyrtar deri me datën 02 Tetor 2015.<sup>41</sup>

#### **Nëntor, 2015**

Me datën 17 Nëntor 2015, AQP-ja publikoi njoftimin për dhënie të kontratës me të cilën kishte përzgjedhur dy operatorë ekonomik për dy pjesë (lote) të kontratës kornizë për furnizim me material zyrtar me Nr. AQP 15 002 111.

#### **Dhjetor, 2015**

Me datën 08 Dhjetor 2015 dhe datën 10 Dhjetor 2015 Kontrata për Furnizim - Kontratë Publike Kornizë për Furnizim me Material Zyrtar ishte nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës të AQP-së.<sup>42</sup>

#### **Qershor, 2016**

Operatori ekonomik ka nënshkruar kontratën me datën 27 Qershor 2016.<sup>43</sup>

#### **Gusht, 2016**

Kjo kontratë është nënshkruar nga Ministri i Financave, Avdullah Hoti dhe bërë efektive përfundimisht me datën 04 Gusht 2016.<sup>44</sup>

### **Prokurimi me Nr: AQP 15 004 111 me vlerë prej 2.8 milion Euro.**

#### **Korrik, 2015**

AQP-ja, me datën 1 Korrik 2015 inicoi procedurën e prokurimit me Nr. AQP 15 004 111, për furnizim me goma të veturave për institucionet publike, duke publikuar njoftimin për kontratë për këtë tender.<sup>45</sup>

#### **Gusht, 2015**

Me datën 11 Gusht 2015 AQP-ja, vazhdoi afatin për dorëzimin e tenderëve në lidhje me procedurën e prokurimit Nr. AQP 15 004 111, deri me datën 28 Gusht 2015.<sup>46</sup>

#### **Nëntor, 2015**

Me datën 19 Nëntor 2015, OSHP-ja kishte pranuar si të bazuara ankesat e dy operatorëve ekonomik dhe e kishte detyruar AQP-në, që të ri-tenderoj procesin e prokurimit me Nr. AQP

<sup>39</sup> Njoftimi për Anulim të Aktivitetit të Prokurimit, 23 Korrik 2015.

<sup>40</sup> Njoftimi për Kontratë Ritender, AQP 15 002 111, 28 Gusht 2015.

<sup>41</sup> Njoftimi për vazhdim të afatit, AQP 15 002 111, 22 Shtator 2015.

<sup>42</sup> Kontrata për Furnizim - Kontratë Publike Kornizë për Furnizim me Material Zyrtar Lot II, AQP 15 002 111.

<sup>43</sup> Po aty.

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> Njoftimi për Kontratë, AQP 15 004 111, 01 Korrik 2015.

<sup>46</sup> Njoftimi për vazhdim të afatit, AQP 15 004 111, 28 Gusht 2015.

15 004 111 për furnizim me goma.<sup>47</sup> Me datën 24 Nëntor 2015, AQP ritenderoi kontratën për furnizim me goma me Nr. AQP 15 004 111.<sup>48</sup>

### **Dhjetor, 2015**

Me datën 10 Dhjetor 2015 AQP-ja, vazhdoi afatin për dorëzimin e tenderëve për procesin e prokurimit Nr. AQP 004 111 deri me datën 21 Dhjetor 2015.<sup>49</sup>

### **Janar, 2016**

Me datën 26 Janar 2016, AQP-ja publikoi njoftimin për dhënie të kontratës me të cilin përzgjodhi operatorin ekonomik, për furnizim me goma pas procesit të ritenderimit.<sup>50</sup>

### **Shkurt, 2016**

Me datën 08 Shkurt 2016 dhe datën 15 Shkurt 2016, Kontrata për Furnizim - Kontratë Publike Kornizë për Furnizim me Goma - Ri tender, ishte nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës të AQP-së.<sup>51</sup>

### **Qershor, 2016**

Operatori ekonomik ka nënshkruar kontratën me datën 21 Qershor 2016.<sup>52</sup>

### **Gusht, 2016**

Kjo kontratë është nënshkruar nga Ministri i Financave, Avdullah Hoti dhe është bërë efektive përfundimisht me datën 04 Gusht 2016.<sup>53</sup>

---

<sup>47</sup> Vendimi i OSHP-së PSH Nr. 423/15 dhe 424/15, i datës 10 nëntor 2015, publikuar me datën 19 nëntor 2015.

<sup>48</sup> Njoftimi për Kontratë Ritender, AQP 15 004 111, 24 Nëntor 2015.

<sup>49</sup> Njoftimi për vazhdim të afatit, AQP 15 004 111, 10 Dhjetor 2015.

<sup>50</sup> Njoftimi për dhënie të kontratës, AQP 15 004 111, 26 Janar 2016.

<sup>51</sup> Kontrata për Furnizim - Kontratë Publike Kornizë për Furnizim me Goma Ri tender, AQP 15 004 111.

<sup>52</sup> *Po aty*.

<sup>53</sup> *Po aty*.

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



[www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org) | [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org)  
Rr. Andrea Gropa No.35 10000 Prishtinë – Kosovë